



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Primjeñe/Prodato Received/Delivered	27 - 10 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KESHILLI	6498/2022		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.824/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.824/2022 të datës 23.09.2022, të parashtruar nga grupi i ankueseve:

dhe të cilat me autorizim i përfaqëson me adresë

Komuna e Prishtinës , kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 27.10.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.824/2022, e datës 23.09.2022 e parashtruar nga

**A r s y e t i m**

Ankueset e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.388 te datës 16.12.2014 ne pozitën "Zyrtare e Financave" e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.27 të datës 27.07.2017 në pozitën "Zyrtare e Lartë për Skema Pensionale" si dhe ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.02 të datës 07.02.2018 në pozitën "Drejtoreshë e Departamentit Ligjor" përmes përfaqësueses se autorizuar me datën 06.09.2022 kanë parashtruar kërkesë me numër prot.1913-3/2022 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore si dhe shtesave të tjera, ndërsa me datën 23.09.2022 përmes përfaqësues ligjore kanë parashtruar ankesën me numër te protokollit 5638/2022, në Këshillin e Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore dhe shtesave tjera.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 27.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me datën 03.10.2022 kjo e fundit ka përcjellë dokumentacionin lidhur me ankesën e ankueses së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova;* Ankesën me numër të protokollit 5638/2022 të parashtruar nga ankueset në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën Nr.Prot.1913-3/2022 e datës 06.09.2022 e parashtruar nga ankueset tek organi i punësimit; Akt emërimit e ankueses Nr.Prot.388 te datës 16.12.2014; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore e ankueses për Akt emërimit Nr. Prot/27 te datës 27.07.2017; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore për palën Akt emërimit Nr.Prot.02 të datës 07.02.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen ne ankesë te datës 03.10.2022 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Listën e pagave për ankuesen; Listën e pagave për muajin gusht të vitit 2017 për Akt emërimit Nr.Prot.27 të datës 27.07.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueseve dhe *është e pa lejuar, sepse:*

Ankueset e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.388 te datës 16.12.2014 ne pozitën "Zyrtare e Financave", e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.27 të datës 27.07.2017 në pozitën "Zyrtare e Lartë për Skema Pensionale" si dhe ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.02 të datës 07.02.2018 në pozitën "Drejtoreshë e Departamentit Ligjor" përmes përfaqësueses se autorizuar me datën 06.09.2022 kanë parashtruar kërkesë me numër prot.1913-3/2022 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore si dhe shtesave të tjera, mirëpo ankueset deri me datën 23.09.2022 nuk ka marr përgjigje nga organi i punësimit dhe me datë 23.09.2022 përmes përfaqësues ligjore kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore dhe shtesave tjera.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueseve, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është*

dizetepesë (45) ditë nga fillimi i saj'', andaj duke marre parasysh dëshmitë e ofruara nga ankueset dhe organi i punësimit Kolegji konstatoi se ankueset përmes përfaqësueses së autorizuar më datë 06.09.2022 kanë parashtruar kërkesë me numër prot.1913-3/2022 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore si dhe shtesave të tjera, ndërsa me datë 23.09.2022 përmes përfaqësues ligjore kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankueset, me datë 23.09.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e para afatëshme respektivisht ankesa nga ankueset është parashtruar ende pa përfunduar afati i përcaktuar ligjor për përfundimin e procedurës administrative prej dizetepesë (45) ditëve ashtu siç përcaktohet me nenin 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Kolegji i Këshillit duke u bazuar në faktet e lartcekura konstatoi se ankesa e ankueseve është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafi 1 dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

*Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.824/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësueses ligjore të ankueseve
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

